

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pasojat e rezultateve nga zgjedhjet/ Merz anulon vizitën në OKB, mbledh CDU-në
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/-e-rezultateve-nga-zgjedhjet-merz-anulon-viziten-ne-okb-mbled-i474994
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:59:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 13:39:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	38d2347d57b13422d07189d265edf6bfbcf5d462ce39291daeea7f59971035fc
TEKSTI	d7af147dd2d92f2e99df415ac145e88e38809498bfddd7e190a84fc90ec8f2d8
PAMJA	555a160355ea539c96fa8f84146fa3a78f1df7c87d61e4f7d43896a5b36dfa27

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a1752695efa88db05de735b62ba8e5ad40c089d1d2b0af2df4b90ff299ffefffb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a1752695efa88db05de735b62ba8e5ad40c089d1d2b0af2df4b90ff299ffefffb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Pasojat e rezultateve nga zgjedhjet/ Merz anulon vizitën në OKB, mbledh CDU-në



23 Shtator 2026, 15:39, Kosova & Bota CNA



Kancelari Friedrich Merz do duhej të ishte në Nju Jork, në Kombet e Bashkuara ku zhvilloheshin punimet e Asamblesë së Përgjithshme. Por ai e anuloi udhëtimin në SHBA për t'u marrë me pasojat e rezultateve të dobëta zgjedhore që partia e tij, CDU, pësoi fundjavën e kaluar në Mecklenburg-Vorpommern dhe Berlin. Të martën pasdite (22.09) u mbledhën deputetët e CDU-së dhe CSU-së për të debatuar pas rezultatit historikisht të dobët në zgjedhjet e Meklenburg-Pomeranisë dhe Berlin, në një atmosferë të rëndë, siç u tha.


Në media madje flitej këto ditë për "muzgun politik" të kancelarit. Disa përshpërisnin edhe për një revoltë të mundshme brenda grupit parlamentar. Por revoltë nuk pati. Nga qarqet e CDU thuhet se atmosfera e takimit nuk ishte e lehtë pas humbjes së rëndë zgjedhore të CDU. Deputetët thanë se Merz edhe njëherë në takimin e grupit parlamentar të Unionit kërkoi të vazhdohej kursi i reformave. Daniela Ludwig, ish-e ngarkuar e qeverisë federale për çështjet e drogës nga radhët e CSU-së, ngriti një pyetje retorike: "Po çfarë do të përmirësonte një revolucion?", duke shtuar, se "revolucionet deri më sot nuk kanë ndryshuar kurrë asgjë për mirë", sipas mediave.

Kurse deputeti i CDU-së nga Saksonia e Poshtme, i pyetur për kancelarin, u përgjigj menjëherë: "Kancelari mbetet." Sipas tij, për këtë nuk ka asnjë dyshim.

"Por kancelari me siguri e ka kuptuar gjithashtu se duhet të ndryshojmë disa gjëra. Dhe pikërisht për këtë ai tha se duhet të shohim drejt së ardhmes." Kreu i grupit parlamentar, Thorsten Frei është i mendimit të shikohet tanimë drejt së ardhmes. Para mbledhjes me kancelarin, ai analizoi situatën: "Zgjedhjet e fundjavës nuk ishin thjesht zgjedhje proteste." Frei shtoi, se "përtej kësaj, ato treguan edhe se ka boshllëqe në trajtimin e disa çështjeve tematike. Me këtë duhet të merremi, duhet ta pranojmë dhe prej saj duhet të nxjerrim mësimet e duhura."

Serap Güler, deputete e CDU-së nga Renani Veriore-Vestfali, e përshkruan kështu rrugën që kancelari synon të ndjekë: "Mendoj se, nga njëra anë, bëhet fjalë për çështjen e drejtësisë sociale. Kancelari federal e bëri të qartë edhe pas mbledhjeve të forumeve drejtuese se në vendin tonë ka shumë njerëz që ndihen të lënë pas dore, që ndihen të përjashtuar nga proceset. Këtyre njerëzve duhet t'u drejtohem më mirë dhe t'i përfshijmë sërish edhe politikisht." Nga ana tjetër, sipas saj, u bë fjalë edhe për reformat: "Ne po zbatojmë reforma në mënyrë që vendi të mbetet i aftë për të përballuar të ardhmen edhe pas 30 vjetësh dhe që të ruhet drejtësia mes brezave."

Por si mund të vazhdojnë kurisi reformave dhe njëkohësisht të vinet në shprehje të drejtës sociale? Të harmonizohen interesat e Unionit dhe të shteteve? Zëvendëskryetari i grupit parlamentar, Mathias Middelberg, beson se kjo është e mundur. Megjithatë, sipas tij, të gjithë janë të vetëdijshëm se kanë vetëm një mundësi: të veprojnë të bashkuar si grup parlamentar i Unionit dhe, në fund, edhe si qeveri. "Nëse tani lejojmë që të përçahemi, atëherë nuk do të dështojë vetëm kjo qeveri, por në fund do të dështojë edhe ky vend." Takimi i Unionit përfundoi pa pasoja të rënda për kancelarin. Merz mori mbështetjen e deputetëve të tij dhe kaloi një provë politike që, paraprakisht, dukej shumë më e vështirë./dw



Të sugjeruara

"Kuvendi të zgjedhë nënkryetarin e dytë"/ GJK: Qeveria e Kosovës është zgjedhur në mënyrë kushtetuese

Edhe pse shumë herët, gara presidenciale e vitit 2028 në SHBA ka nisur/ Emrat e mundshëm të kandidatëve

AfD në Saksoni-Anhalt/ Çfarë është "detyrimi i federatës"?

Kallas takon Kurtin dhe Vuçiç-in: Marrëveshja e Ohrit është e detyrueshme

Fjalimi në OKB/ Trump zbulon afatin, ja kur pritet të arrijë marrëveshje paqeje me Iranin

Spanja mund ta pengojë integrimin e Malit të Zi në BE

Trump në OKB: Po shoh mundësinë e "asgjësimit" të Iranit, t'i dërgoj në ferr

"Super Inteligjenca"/ Trump "riemërton" IA-në, hedh poshtë thirrjet për rregullore globale

Bojkoti i madh në SHBA/ Televizionet kryesore ndërpresin mbulimin e Trump

Të shtëna me armë në një shkollë në Turqi/ Plagosen 11 nxënës

Kryeministri britanik Andy Burnham do të takohet me Trump-in për herë të parë në OKB në Nju Jork

Kurti takon Erdogan-in: Diskutua aktgjykimin e padrejtë të Speciales, të korrigjohet në Apel

Hetimet ndaj Granit Xhakës/ Ja sa vite burg rrezikon futbollisti

Zbulim tronditës në Sri Lanka/ Varr masiv me 572 trupa nga koha e luftës civile

Trump: Sulm ndaj lajmeve të rreme, po përhapen si kancer

Kurti kritikon aktgjykimin e Speciales në Hagë

Një cisternë goditet nga një predhë në Ngushticën e Hormuzit


Turqia likuidon 131 fonde të përfshira në një skemë të dyshuar të tipit "Ponzi"

Rusia shpall fitoren rekorde të partisë së Putin-it/ BE kritikon zgjedhjet

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ PDK çon në Kuvend nismën për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale

[editorial](#)

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

20:06 Opinione Grigels Muçollari

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

19:14 Opinione Luan Rama

TRADHËTIA NDAJ SHTETIT

22:05 Opinione Luan Rama

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

[Lifestyle](#)

14:00 Lifestyle

Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur

Presley Gerber, oja i supermodelles Cindy Crawford, ka na...

09:00 Lifestyle

Jeshilja e ullirit/ Si ta kombinoni ngjyrën elegante që po "pushton" vitin

Jeshilja e ullirit po rikthehet fuqishëm dhe premton të bë...

07:38 Lifestyle

Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

20:40 Lifestyle